



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.2215/23

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit kreditorit TEB Sh.A., me seli në zyrën qendrore në Prishtinë, me adresë Preoc p.n, Graçanicë 10500, km 7, magjistralja Prishtinë-Ferizaj, Republika e Kosovës, kundër debitorëve 1. KOS-PROFI Sh.P.K., me adresë në rrugën “...” nr.42/4 në Prishtinë, me NRB: 70142379, 2. M.J., me adresë në rrugën “...” nr.42/4, në Prishtinë, 3. I.Z., me adresë në Uglarë, Fushë Kosovë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1960/23 të datës 27.11.2023, të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 05.02.2024, merr këtë:

### A K T V E N D I M

I.REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorëve 1. KOS-PROFI Sh.P.K., me adresë në rrugën “...” nr.42/4, në Prishtinë, me NRB: 70142379, 2. M.J., me adresë në rrugën “...” nr.42/4, në Prishtinë, 3. I.Z., me adresë në Uglarë, Fushë Kosovë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1960/23 të datës 27.11.2023, të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

### A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit TEB Sh.A., në bazë të titullit ekzekutiv Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike II.EK.nr.700/19 të datës 28.12.2021, ka nxjerrë urdhrin P.nr.1960/23 të datës 27.11.2023, me të cilin ka urdhëruar që të bllokohen menjëherë të gjitha llogaritë bankare të debitorëve, përfshirë të gjitha llogaritë personale të udhëhequra në të gjitha bankat komerciale në Republikën e Kosovës, të sekuestrohen të gjitha mjetet financiare deri në shumën 70,075.83 Euro nga këto llogari bankare,

dhe të urdhërohet bartja e tyre në llogarinë bankare të debitorit pranë TEB Sh.A. Të regjistrohen dhe bllokohen menjëherë të gjitha pasuritë e luajtshme pranë Qendrës së Regjistrimit të Automjeteve, Agjencionit të Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, si dhe pasurive të paluajtshme pranë Agjencionit Kadastral të Kosovës ndaj të gjithë debitorëve, si dhe të sekuestrohen dhe bllokohen menjëherë të gjitha pasuritë e luajtshme të debitorëve të lartcekur ku pas regjistrimit apo sekuestrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të realizohet për të njejtat edhe shitja e tyre. Të shiten përmes ankandit publik pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe nga shitja e tyre të realizohen obligimet e debitorëve ndaj kreditorit dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, si dhe të detyrohen debitorët e lartcekur që kreditorit t'ia lirojnë nga njerëzit dhe sendet paluajtshmëritë, pas procesit të cekur në pikën IV të dispozitivit të urdhrit përbarimor, dhe që këto paluajtshmëri tërësisht t'ia dorëzojë kreditorit në shfrytëzim të mëtutjeshëm.

Kundër urdhrit përbarimor, debitorët brenda afatit ligjor kanë paraqitur prapësim, me të cilin e kanë kundërshtuar urdhrin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, aplikimit të gabuar të ligjit material, dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë që ka juridiksion për të vendosur për ankesë kundër urdhrin për përbarim, dhe gjykata që kryen përbarimin, mund të shtyjnë përbarimin me kërkesë të debitorit, që mund të mos obligohet që të deponojë pengun kur debitori merr pjesë në procedurë si palë, nëse përcakton gjasën se përbarimi do t'i shkaktonte dëmtim të pariparueshëm apo gati të parandalimit të dhunës. Tutje kanë shtuar se urdhri përbarimor është marr duke shkelur dispozitat procedurale të përcaktuara me LPP, për arsye se Përbaruesi ka qenë i detyruar që para vendosjes lidhur me propozimin e kreditorit, në afatin ligjor t'ia përcjell debitorit duke i dhënë mundësinë ligjore për përgjigje në të njejtin. Debitorët i kanë propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi dhe të anulohet urdhri i Përbaruesit Privat.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka paraqitur përgjigje në prapësim, në të cilin ka theksuar se urdhri përbarimor është sjell pa shkelje të dispozitave procedurale, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe janë aplikuar dispozitat e ligjit material. Ka shtuar se aktgjykimi mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi, paraqet dokument përbarues dhe i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 27.1 të LPP-së, si dhe i njejtë është bërë i

formës së prerë dhe i ekzekutueshëm. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit, dhe të vërtetohet urdhri përmbarimor i Përmbaruesit Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, deklarimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike II.EK.nr.700/19 të datës 28.12.2021, në bazë të së cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi.

Gjykata gjeti se aktgjykimi i lartcekur i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, objektin e detyrimit të debitorit dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike II.EK.nr.700/19 i datës 28.12.2021, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe me nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*, ndërsa sipas par.2 të këtij

neni përcaktohet se “Vërtetimin për përmbarueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”, ngase në shkresat e lëndës aktgjykimi në fjalë është deponuar në kopje të vërtetuar sipas ligjit, si dhe është bërë i plotfuqishëm me datë 02.06.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 11.10.2023, e cila vërtetohet nga shënimi zyrtar i datës 07.11.2023, i lëshuar nga Gjykata Komerciale e Kosovës, i cili është i bashkangjitur në shkresat e lëndës.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, por gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08 L-015 për Gjykatën Komerciale, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2215/23, më datë 05.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.